



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Tiranë, 8 maj 2021. Në vijim të masave administrative dhe procedurale të ndërmara nga Prokurori i Përgjithshëm për të garantuar funksionimin normal të prokurorisë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore për periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore, prokuroria është angazhuar për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm.

Nga raportimet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm mbi veprat penale në fushën e zgjedhjeve për periudhën parazgjedhore e deri më datë 07.05.2021 rezulton se prokuroritë kanë regjistruar procedimin penal për 38 njoftime për vepra penale në lidhje me zgjedhjet dhe janë në proces verifikimi paraparak 50 njoftime për veprat penale si më poshtë:

### **Veprat penale në fushën e zgjedhjeve**

- Neni 325, Pengimi i subjekteve zgjedhjore
- Neni 326, Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve
- Neni 326/a, Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor
- Neni 327, Shkelja e fshehtësisë së votimit
- Neni 327/a, Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar
- Neni 328, Korrupsioni aktiv në zgjedhje
- Neni 328/a, Përdorimi i funksionit publik për veprimt. politike ose zgjedh.
- Neni 328/b, Korrupsioni pasiv në zgjedhje
- Neni 329, Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje
- Neni 330, Pengimi i zgjedhësit
- Neni 330/a, Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve
- Neni 331, Shkelja e të drejtës së zgjedhjes
- Neni 331/a, Marrja ose përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit
- Neni 332, Shpërdorimi i autoritetit ushtarak
- Neni 332/a, Shpërdorimi i autoritetit policor
- Neni 248, Shpërdorimi i detyrës në lidhje me aktet ligjore për zgjedhjet

Aktualisht janë 10 persona të cilët po ndiqen penalisht për veprat e mësipërme, janë arrestuar në flagrancë 5 persona, është kërkuar masa e sigurisë “arrest në burg” për 4 persona dhe është pranuar kërkesa për 3 persona.

Përgjatë kësaj periudhe prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë marrë në total 125 njoftime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve, prej të cilave: -82 kallëzime në prokurori nga subjekteve politike/kandidatë, shtetas apo institucione shtetërore;- 20 referime të policisë gjyqësore dhe - 23 ardhur me transferim nga SPAK.